



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPLAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 10832 Dok. 15

Vlorë, më: 28. 09. 2022

DËGJESË PUBLIKE

Mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe planifikimi për Projekt Buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë Vlorë

RAJONI 4

Data 21.09.2022: ora 10.00

Pjesëmarrës: Nënkyetarja e Bashkisë, Kryetari i Rajonit 4, Banorë dhe përfaqësues të komunitetit, anëtarë të këshillit bashkiak, drejtorë të administratës dhe Institucionit të Bashkisë Vlorë, shoqëria civile, media lokale. (listëprezenca bashkangjitur).

Aalon Spaho: Kryetari i Rajonit 4: Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Jemi mbledhur për të diskutuar me publikun për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe planifikimin për Projekt buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë Vlorë dhe specifiksht të adresojmë problematikat e rajonit 4.

Qytetar I kujt viti? Nga bashkia kë kemi? Është drejtori i urbanistikës?

Daut Zeraj: Ju falenderoj te gjitheve per pjesemarrjen. Si në çdo rajon e njësi administrative po realizohen takime për të marr mendime nga komuniteti per planifikimin e buxhetit 2023 dhe Planifikimi per buxhetin afatmesem 2023-2025.

Treguesit për planifikimin janë: per vitin 2023 pak a shume si 2022, nuk do te kete ndryshime te konsiderueshme. Varet edhe nga te ardhurat. Nuk jane parashikuar rritje te taksave dhe tarifave.

Per vitin 2024 dhe 2025 jane parashikuar rritje te te ardhurave dhe shpenzimeve. Nuk ka te parashikuar rritje te fondit te pages dhe ndryshim te strukturave.

Per vitin 2023 jane parashikuar rritje te fondit te investimeve rrëth 79 milion dhe per vitin 2025 rrëth 46 milion per rikonstruksionin e shkollave dhe arsimit baze.

Per sa i perket prioriteteve te Rajonit 4 jane parashikuar ne buxhetin afatmesem 2023-2025:

- Rikonstruksioni dhe rikonceptimi i fushes se avacionit

Rikonstruksioni i Pallatit te Kultures

Pastrimi

ana juaj na jepni prioritetet që keni. Te shikohen investimet me vlerë të vogël që të mund ti azojmë.

Qytetar Në datën 7 Nëntor kemi diskutuar njësoj si sot. Në lagjen time janë 750 shtëpi rrugë. Janë vetëm 820 m linear, rrugë e cila është lënë përgjysëm dhe është shtruar vetëm aty kanë patur interesin disa biznese. Bëhet fjalë për rrugën në zonën industrial. Unë dua të më njooni llogari për kërkesat që kam parashtruar. Aty ka banorë me probleme sociale, familje në nevojë. Rruja është pa shpronësimë, pa kanilizime, rrugë me kalldrëme e cila sipas një krevetivë shkon deri në 8 milion lekë.

Ka nevojë gjithashtu të bëhen pastrimet e kanalizimeve. Bëhet fjalë për rrugën nr.22 pranë hidrovorit, detyrë e parealizuar deri tani nga ana e bashkisë. Do kërkon votën, ajdeni rregullojeni.

Qytetar : Për kanalin ca do bëhet? Kur do mbulohet? Pastrimin e kemi bërë vetë deri tani, por hajdeni mbulojeni.

Qytetar : Ne kemi problemin me terrenin, nga fusha e vaiacionit deri te hidrovori. Rruja, legalizimi I zones është ndërprerë, zyra e urbanistikës duhet të ej project. E kemi thënë edhe herë të tjera. Ujë nuk kemi. Asfalti është i prishur nga ndërhyrjet. Ajde kontrolloni firmat që bëjnë punimet.

Aulona Veizi: Kanali nuk mund të mbyllët, por do të pastrohet, sepse ndihmon qytetin me kanalizimet e ujit të shiut. Nuk lejohet legalizimi i shtëpive në buzë të kanalit, nuk e lejon ligji.

Qytetar Hajdeni dhe shikoni gjendjen. Rruja eshtë e ngushtë, ambulance nuk kalon dot, zjarrfiksja jo, mbeturinat nuk janë pastruar, kanalizimet janë problem.

Qytetar : Rruja është pa mbulesa për kanalin.

Qytetar Investimet e medhaja i bën qeveria.

Qytetar Rajoni 4 është aprë me hatër sepse ka investime nëpër lagje, të marrin vlerë tamam zgjidhni dhe problemin e tregut të shkatërruar, pllakat de të përmirësoset higjena.

Daut Zeraj: Tregu është investim I Bashkisë Vlorë, por I është kthyer privatit nga Komisioni I Kthimit të Pronave, megjithëse pjesa e kontrollit të pastrimit dhe higjenës si dhe menaxhimin e ka bashkia.

Qytetar para shkollës Jani Minga, koshat e plehrave janë në kushte të këqija. Të sistemohen. Pastrimi s'ka cilësi nëse ska bashkëpunim mes qyetatrëve dhe institucionit. S'ka kulturë. Si ta zgjidhim?

Aulon Spaho: Faleminderit për pjesëmarrjen. Do shikohen problematikat dhe do të kontaktojmë prapë.

